

## Legjionaret/ Vajushi shenon golin e peste ne Bullgari

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 30 Tetor 2013 23:11

---



Armando Vajushi nuk di te ndalet para portave kundërshtare. Sulmuesi shkodran ka shënuar serish për Liteksin dhe është ngjitur në kuotën e pesë realizimeve për këtë sezon. Vajushi ka ndihmuar Liteksin të marrë një fitore të pastër ndaj Lokomotives së Sofjes. Shkodrani ka shënuar golin e dytë dhe ka asistuar në rastin e golit të katërt. Në këtë ndeshje ka luajtur për Liteksin edhe shqiptari tjetër Jurgen Gjasula, por Vajushi ka qenë lojtari i ndeshjes.